



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr.110/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi– Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik OE: “Engineering Group” Sh.P.K, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik OE: “NB. Projekt” Shpk & NPN “Alping” & “Alping” Shpk-Deçan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Qendrës rinore në Deçan” me nr. prokurimit: 631-19-6725-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Deçan, më datë: 03.03.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Engineering Group” Sh.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Qendrës rinore në Deçan” me nr. prokurimit: 631-19-6725-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Deçan.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: “Ndërtimi i Qendrës rinore në Deçan” me nr. prokurimit: 631-19-6725-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Deçan dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik “Engineering Group”Sh.P.K aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Sqarim rreth iniciave për procesin e prokurimit :

Autoriteti kontraktues në tekstin e më poshtëm AK ;

Operatori ekonomik në tekstin e më poshtëm OE ;

Dosja e Tenderit në tekstin e më poshtëm DT ;

Njoftimi për Kontratë në tekstin e më poshtëm NJpK ;

Ligji për Prokurim Publik-në tekstin e më poshtëm LPP;

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publiken tekstin e më poshtëm- RRUOPP

Organi Shqyrtues i Prokurimit në tekstin e më poshtëm –OSHP;

Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik në tekstin e më poshtëm -KRPP

Operatori ekonomik ankues “Engineering Group”Sh.P.K”, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 18.02.2020 me nr 110/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Qendrës rinore në Deçan” me nr. prokurimit: 631-19-6725-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Deçan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 59 , 57 dhe 61 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 19.02.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 21.02.2020 sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 7, 59, 61 të LPP-së dhe B57 Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët. Eksperti shqyrtues sqaron, se marr për bazë që ky aktivitet i prokurimit është përsëritur disa herë, dhe ky aktivitet i prokurimit është shqyrtuar më parë dhe e konsideroj si çështje të gjykuara “**res judicata**”, mirëpo duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe vendimin nga PSH .nr. 755/19 të datës 03.12.2019 dhe urdhëresës nga PSH .nr. 938/19 të datës 27.01.2020, konsideroj se grupi i OE ankues, nuk ka arritur të dëshmojë interes material nga rezultati i këtij aktiviteti të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Deçanit, në pajtim të **nenit 4 par. 1 pika 26 të LPP-së**, e të cilin thuhet: 1.26. **Palë e interesuar** - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar, andaj pretendimet e grupit të OE ankues, nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **të refuzohet si e pa-bazuar**, dhe rekomandon që të mbetet në fuqi B58 njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues (njoftimit për dhënie të kontratës).

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës 24.02.2020 ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës 24.02.2020 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 03.03.2020, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, Eksperti shqyrtues profesional, ndërsa përfaqësuesit e AK-së nuk janë prezent në seance, te njëjtë i kemi njoftuar në mënyrë të rregullt për mbajtjen e kësaj seance dhe të njëjtë nuk na kanë njoftuar me arsyen e mos prezencës se tyre në seance, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Hodaj deklaroi: Elaborim i përgjigjes ndaj ekspertizës së ekspertit shqyrtues profesional.

Para se të jap vlerësimin në lidhje me ekspertizën e ekspertit shqyrtues, me leje të PSH kërkoj të më lejohet i bëj ca pyetje të shkurta për ekspertin në lidhje me ekspertizën e tij.

1. Në ekspertizë e cekni se në bazë të vendimeve PSH. 755/19 dhe PSH 938/19 kjo çështje është çështje e gjykuar apo res judicata? Në vendimet që thirreni kush ka qenë palë ankuese?
2. Objekt i shqyrtimit të vendimeve të cekura nga ju a kanë qenë pretendimet ankimore të OE tani të rekomanduar për kontratë apo pretendimet ankimore të OE që unë përfaqësoj?
3. A janë pretendimet e njëjta ankimore të ankesës sonë që ju keni shqyrtuar me pretendimet ankimore të shqyrtuar me vendimet që ju i referoheni në vendimet PSH. 755/19 dhe PSH 938/19?
4. Në ekspertizë ju e vlerësoni se në bazë të vendimeve PSH. 755/19 dhe PSH 938/19 OE ankues nuk është palë me interes? A mund të na tregoni se ku thuhet në këto vendime që OE ankues tani dhe të konsiderohet palë pa interes ose që AK duhet ta vlerësoj në këtë mënyrë?

Përgjigjet e Ekspertit:

Qëndroj pranë përgjigjes sonë të bërë me datë 24.02.2020 ndaj ekspertizës me numër 110/20 të Ekspertit Shqyrtues Sahit Beqiri. Kjo ekspertizë nuk shqyrton asnjë nga pretendimet tona ankimore por ai vetëm me nga një rresht konstaton se nuk jemi palë të interesit sipas nenit 4.1.26 të LPP-së, dhe çështje është e gjykuar apo res judicata, mirëpo ai nuk e ka dhënë asnjë arsyetim për këtë konstatim të tij.

Ekspertiza e z. Beqiri është shume e mangët për të mos thënë joprofesionale pasi ai ka konstatuar që ne jemi palë pa interes pa dhënë arsyetim fare e për më tepër duke cituar gabimisht dy vendimet e OSHP-së. OSHP në të dy vendimet e saj 755/19 dhe 938/19 ka thënë që të zbatohet neni 61, gjë të cilën AK nuk e ka bërë dhe në asnjë pjesë të këtyre vendimeve nuk përmendet termi palë pa interes.

Pse nuk qëndron vlerësimi që ne si grup i OE jemi palë pa interes? Konzorciumi që unë përfaqësoj me anë të ankesës ka dëshmuar interes material nga ky aktivitet i prokurimit, shkeljet e sqaruara në ankesë rrezikojnë të dëmtojnë konzorciumin që unë përfaqësoj dhe AK poashtu. Keq- Interpretimi ekspertit shqyrtues na diskriminon dhe dëmton ne në krahasim me OE të rekomanduar për kontratë dhe i kushton më shtrenjtë buxhetit të Komunës së Deçanit për 18,663.30 euro. Në asnjë mënyrë nuk qëndron konstatimi vetëm me një rresht i ekspertit shqyrtues që ne jemi palë pa interes, pasi në vendimet e OSHP ku ai i referohet në asnjë pjesë nuk përmendin termin palë pa interes. Kështu që konform nenit 4.1.26 të LPP-së ne i plotësojmë plotësisht kushtet ligjore që të jemi palë me interes

Poashtu, nuk qëndron konstatimi ekspertit shqyrtues që trajton ankesën tonë si çështje të gjykuar apo “res

judicata”. Për tu konsideruar çështja e gjykuar dhe kur e nga kush duhet të trajtohet si **res judicata**, sqarohet mirë me nenin 105.2.16 të LPP-së dhe me Rregulloren Nr. 01/2017 të OSHP-së, neni 16 (Rastet e Unifikuara) para. 2 dhe 3. 2.16. Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”. Sipas këtij neni dhe rregullores së lartcekur, si çështje res judicata konsiderohet vetëm nëse pretendimet ankimore janë të njëjta, objekti i kontesti është i njëjtë dhe palët janë të njëjta, atëherë paneli shqyrtues duhet ta trajtoj çështjen si res judicata. Pra të rasti konkret me ankesën e konzorciumit që unë përfaqësoj nuk janë pretendimet ankimore të njëjta pasi asnjëherë më parë nuk janë trajtuar këto pretendime ankimore, objekti nuk është i njëjtë, pasi më parë objekt i ankesës ka qenë pretendimi për mos përgjegjshmëri të ofertës së konzorciumit që unë përfaqësoj, ndërsa të rasti i ankesës tonë objekt i i kontestit është mos përgjegjshmëria e ofertës së OE NB Projekt Shpk etj. Pa marrë parasysh nëse mund të konsiderohen palët e njëjta, të ky shqyrtim kemi pretendime të ndryshme dhe objekt i ndryshëm i kontestit nga ai i shqyrtuar me dy vendimet e OSHP-së, 755/19 dhe 938/19 siç pretendon ESH.

Për më tepër sipas nenit 16 të rregullores së lartcekur eksperti shqyrtues angazhohet për të shqyrtuar pretendimet ankimore, së pari dhe tek pastaj t’i jap një rekomandim panelit se çfarë të bëjë me ankesën, nëse duhet miratuar apo refuzuar atë. Eksperti në këtë rast nuk ka shqyrtuar pretendimet ankimore, vetëm është ka thënë se lënda është e gjykuar. Kjo kompetencë nuk i takon ekspertit shqyrtues, por konform bazës ligjore të lartcekur i takon Kryetarit të OSHP-së apo Kryesuesit të Sekretariatit, por në asnjë mënyrë dhe asnjëherë ekspertit shqyrtues. Eksperti ka përshkrim të detyrës shumë të qartë dhe ajo është shqyrtimi i pretendimeve ankimore të operatorit ankues, çështjet e tjera nuk janë në përshkrimin e detyrave të tij. Eksperti shqyrtues në njërin anë në përgjigje të pretendimit nr. 1 thotë që kjo çështje është e gjykuar ndërsa në fund rekomandimi është që të refuzohet ankesa. Këto dy konstatime të tij janë kontradiktore.

II. Elaborim dhe analize e pretendimeve ankimore

Pra eksperti shqyrtues nuk i ka shqyrtuar pretendimet e OE ankues, dhe pasi nuk qëndrojnë konstatimet e ekspertit shqyrtues që kinse ne nuk jemi palë me interes dhe kinse çështja është e gjykuar, edhe njëherë falënderoj Panelin Shqyrtues që ka caktuar këtë seance, ku kërkoj shqyrtoj me kujdes të shtuar pretendimet tona ankimore të paraqitura në mënyrë të detajuar në ankesën tonë, por edhe shumë shkurt do të përmbledh edhe njëherë pretendimet tona ankimore dhe arsyet se pse paneli shqyrtues duhet të miratojë ato:

1. Komuna e Deçanit pas vendimit 755/19 të OSHP-së ka vepruar sipas Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët dhe ka kërkuar sqarime për disa nga pozicionet ku ka pasur dyshime. Ne jemi përgjigjur në mënyrë të detajuar se si kemi ardhur te ato çmime, ndërsa komuna është bindur nga

sqarimet tona dhe për t'u siguruar edhe më tutje ka kërkuar që siguria e ekzekutimit të rritet në 20%, të cilën ne e kemi pranuar. Në këtë rast AK ka vepruar sipas nenit 4.6 të këtyre rregullave në të cilën thuhet:

“4.6 Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin meshkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet nëse sqarimi është i mjaftueshëm, **të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë**”.

2. AK në vendimin e fundit për dhënie të kontratës ka bërë diskriminim dhe trajtim të pabarabartë pasi për gjoja çmime jonormalisht të ulëta na ka eliminuar ne, mirëpo konsorciumi i rekomanduar për kontratë ka çmime abuzive dhe jonormalisht të ulëta në disa pozicione dhe në masë shumë më të madhe sesa nga ato për të cilat është ankuar në ofertën tonë. Më poshtë janë të paraqitura disa pozicione, ku NB Projekt ka ofruar çmime abuzive dhe jonormalisht të ulëta:
 - Për shembull, në pozicionin 6.2 i cili ka të bëjë me Furnizimin dhe montimin e mbulesë së kulmit me llamarinë të plastifikuar "SENDUIQ POLIURETAN" trashësia 10.0 cm. Në çmim hyn montimi dhe të gjithë aksesorët për përforcimin e senduiqit. Llogaria në m² - NB Projekt ka ofruar çmim 2.3 euro, ndërsa ne 35 euro. Të bashkangjitura me ankesë janë dy dëshmi për çmimin e tregut për këtë pozicion. Një ofertë nga kompania Metal Ing e cila përfshin vetëm, furnizimin me llamarinë, ka çmim 23.2 euro dhe oferta e dytë nga kompania Solid me çmim 20.5 euro (çmime këto vetëm të furnizimit ku nuk përfshihen shpenzimet përcjellëse si montimi i pajisjeve). Dallimi në mes ofertës së NB Projekt dhe çmimeve të tregut është më shumë se 965%.
3. Përderisa ne jemi eliminuar për kinse çmime jonormalisht të ulëta në pesë pozicione, NB Projekt i ka nëntë pozicione ku ka dhënë çmime abuzive dhe jonormalisht të ulëta me dallime me çmime të tregut mbi 1000%. (të gjitha rastet janë në ankesë). Pra krejt çka po kërkojmë që PSH të aplikoj standardin e njëjtë të rregullave Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët sipas praktikës së njëjtë të vendosur me vendimin me nr 755/19 të OSHP-së.
4. AK ka shkelur nenin 1 pasi nuk ka marrë parasysh qëllimin e Ligjit të Prokurimit pasi ne **jemi më të lirë për 18,663.30 euro** dhe për devijime në çmime të cilat i kemi të dy konsorciumet nuk mundet të në shpallë të papërgjegjshëm, ndërsa NB Projekt ta rekomandojë për dhënie të kontratës. Dallimi në mes ofertës tonë dhe asaj të NB Projekt është më pak se 4% dhe në bazë të kësaj difference nuk mund të cilësohet ofertë jonë si jonormalisht e ulët ndërsa ajo e NB Projekt jo.

5. AK na ka shpallë të papërgjegjshëm në rivlerësimin e fundit gjoja për çmime jonormalisht të ulëta, por nuk ka zhvilluar procedurat siç kërkohen nga Rregulla B57 për çmime jonormalisht të ulëta. Pra AK nuk ka kërkuar fare sqarime ashtu siç kërkohet në nenin 1.2 të këtyre rregullave: “1.2 Në çdo rast , kur ka një prag për tender jo-normalisht te ulët, ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë inter partes me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët.”

Edhe pse njëherë AK është pajtuar me sqarimet tona, rivlerësimi i tenderit nënkuptohet që fillon nga pika zero dhe është dashur që procedura inter partes të zhvillohet përsëri, e jo të eliminohemi drejtpërdrejtë pa kërkuar sqarime.

6. AK nuk ka përdorur formulën e cila është dhënë në nenin 3.1 të Rregullave B57 për të llogaritur se a është tenderi ynë me çmime jonormalisht të ulëta.

Kushti i parë është: çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;

Pasi janë tri oferta atëherë mesatarja e tenderëve është $447,386.90 + 539,360.30 + 433,793.60 = 473,513.6$ euro

$473,513.6 / 1.3 = 364,241.23$ Euro është pragu nën të cilin të gjitha ofertat cilësohen si jonormalisht të ulëta. Oferta jonë është me çmim 433,793.6, e cila është mbi prapun dhe nuk mund të cilësohet si jonormalisht e ulët.

7. OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ISO Certifikatë 9001 për ajrin e kondicionuar, ujësjellës dhe kanalizim, të cilat ishin kërkesa të domosdoshme të dosjes së tenderit.

- Në ofertën e dorëzuar nga operatori ekonomik është dorëzuar lista e certifikatave ISO duke përfshirë edhe Certifikatën ISO 9001. Sidoqoftë, në këtë certifikatë të dorëzuar mungojnë certifikimi për ajrin e kondicionuar, ujësjellës dhe kanalizim. Këto kërkesa janë cekur specifikisht në dosjen e tenderit si kushte themelore kumulative të cilat do të duhej të plotësoheshin.
- Mungesa e këtyre certifikimeve, e bënë të pa certifikuar OE të rekomanduar për kontratë për të bërë kryerjen e plotë të objektit pasi për një çështje të tillë nuk ka standard ISO. Një mungesë e

tillë nuk është vërejtur nga zyrtarët e vlerësimit të AK të cilët në raportin e vlerësimit të tenderëve nuk e kanë cekur një mungesë të tillë.

- Kjo mungesë e bënë të papërgjegjshëm operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë, pasi që Certifikimi ISO është një nga kushtet themelore për të garantuar zbatim të suksesshëm të kontratës dhe kualitet në kryerjen e punëve.

8. OE i rekomanduar për kontratë ka mungesa të dëshmive dhe dokumenteve në listën e pajisjeve të ofruara. Aty mungojnë dëshmitë dhe dokumentet për të paktën 4 pajisje esenciale. Dosja e tenderit ka kërkuar që të dorëzohen për çdo pajisje librezat e qarkullimit apo DUD-i doganor së bashku me foto të pajisjeve.

- Në marrëveshjen e OE të rekomanduar me kontratë Veding SHPK, në listën e pajisjeve mungojnë DUD-at doganore.
- Në marrëveshjen e OE të rekomanduar me Mirusha Company për pajisjen ngarkues i përdorur i prodhuesit O&K, modeli 25.5L, është ofruar kontrata e shitblerjes në mes të Mirusha Company dhe Lika Trade, mirëpo në DUD figuron një pronar tjetër, NTP Agnesa. Pra në DUD doganor kemi një pronar tjetër, ndërsa në marrëveshjen e NB Projekt ka lidhur marrëveshje me një kompani e cila nuk është pronare e kësaj pajisje. Në këtë rast AK nuk duhet të pranojë këtë pajisje, pasi që dy kompani nuk mund të merren vesh për të shfrytëzuar pajisjet e një kompanie të tretë e cila nuk është fare palë në këtë marrëveshje. Për këtë arsye OE NB Projekt duhet të shpallet i papërgjegjshëm.
- Për pajisjen bager të markës Liebherr A904C nuk ka ofruar DUD doganor.
- OE ka prezantuar faturë të shitblerjes për pajisjen Grejder Caterpillar 120G dhe cilindër Caterpillar CS-563E në emër të një kompanie tjetër. Marrëveshja e shitblerjes nuk është në emër të Mirusha Company, por Mirusha Transport. OE i rekomanduar për kontratë NB Projekt nuk ka marrëveshje të shfrytëzimit të pajisjeve me Mirusha Transport.
- OE i rekomanduar për kontratë, përveç se në shumë raste ka mungesa të dëshmive dhe dokumenteve për pajisjet e huazuara nga kompani të tjera, po ashtu vërehet qartë se asnjë pajisje nuk e ka në emër të saj. Të gjitha pajisjet e saja janë të huazuara nga operatorë të tjerë ekonomik, gjë e cila përshkruan më së miri kapacitetet e saja administrative dhe teknike për të realizuar një projekt të tillë siç është ndërtimi i Qendrës Rinore të Deçan. Kur kësaj i shtohen edhe çmimet jo normalisht të ulëta si dhe konstoja e shfrytëzimit të

pajisjeve të operatorëve të tjerë, vërehet qartë se NB Projekt në asnjë rast nuk do të ketë mundësi të realizoj suksesshëm një projekt të tillë të ndërtimit. Po të merren parasysh kushtet ligjore, përkatësisht Neni 4.4 i Rregullës B57 në të cilën kërkohet që kostoja e prodhimit të llogaritet në rastet e çmimeve jo normalisht të ulëta, dhe kësaj i shtohet kosto e shfrytëzimit të pajisjeve, çmimet e këtij operatori do të duhej të ishin shumë më të larta sesa që janë në ofertën financiare. Çmime të tilla të prezantuara vërehet qartë se janë abuzive dhe të pazbatueshme, dhe të cilat garantojnë se kualiteti i ndërtimit do të jetë shumë i dobët ashtu si dhe OE do të kërkojë menjëherë kontratë për punë shtesë, për shkak të çmimeve të ulëta që ka ofruar.

9. III. Përfundimi

10. Rasti i Operatorit Ekonomik në fjalë i cili është rekomanduar për kontratë përbënë definicionin më të saktë të shprehjes pezhorative të një kompanie “Me një kolicë dhe dy punëtor” pasi që e njëjta kompani literalisht nuk ka asnjë pajisje të sajë të dëshmuar në ofertë dhe nuk ka paraqitur as edhe një person të vetëm si staf i kompanisë NB Projekt. Të gjithë punëtorët i përkasin partnerit të vogël në konsorcium i cili është e Biznesi Individual Baser Imeri (Alping). Një operator i tillë nuk do të duhej as të lejohej që të aplikonte në këtë tender, dhe aq më pak të rekomandohet për dhënie të kontratës.
- 11.
12. Rrjedhimisht, kërkoj nga PSH që të mos i'a fal besimin ekspertizës së ekspertit shqyrtues, të mos lejojë me arsyetim të njëjtë sikur të ESH (si mos-trajtimin i pretendimeve ankimore apo konstatime pa arsyetime) të aplikohet edhe me rastin e vlerësimit nga PSH të pretendimeve tona ankimore, pasi në këtë mënyrë do të legjitimohej dhe shpërblehej me kontratë konsorciumi i rekomanduar që është vërtetuar ka çmime abuzive dhe jonormalisht të ulëta në disa pozicione dhe në masë shumë më të madhe sesa nga ato për të cilat është ankuar në ofertën tonë, pra i njëjti në shumë pozicione ka vendos çmime shumë me i lirë sesa çmimi i tregut, e që është në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së dhe Rregullat B57.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Beqiri deklaroj: E dëgjova Avokatin Oferta e juaj që keni ofruar a është me çmim jonormalisht të ulët apo jo?. Mbetem mbrapa raportit të dhënë në ekspertizë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Hodaj deklaroj: Pas të shqyrtoj me kujdes pretendimet tona ankimore dhe argumentet e arsyetimet tona në këtë seancë, kërkoj nga OSHP-ë që të marrë vendim

ku APROVOHET si bazuar ankesa jone dhe ANULOHET vendimi për dhënien e kontratës për OE të rekomanduar për kontrate.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin e OE "Engineering Group" Sh.P.K, se AK në vendimin e fundit për dhënie të kontratës ka bërë diskriminim dhe trajtim të pabarabartë pasi për gjoja çmime jonormalisht të ulëta na ka eliminuar ne, mirëpo konsorciumi i rekomanduar për kontratë ka çmime abuzive dhe jonormalisht të ulëta në disa pozicione dhe në masë shumë më të madhe sesa nga ato për të cilat është ankuar në ofertën tonë. Më poshtë janë të paraqitura disa pozicione, ku NB Projekt ka ofruar çmime abuzive dhe jonormalisht të ulëta:

- Për shembull, në pozicionin 6.2 i cili ka të bëjë me Furnizimin dhe montimin e mbulesë së kulmit me llamarinë të plastifikuar "SENDUIQ POLIURETAN" trashësia 10.0 cm. Në çmim hyn montimi dhe të gjithë aksesorët për përforcimin e senduiqit. Llogaria në m² - NB Projekt ka ofruar çmim 2.3 euro, ndërsa ne 35 euro. Të bashkangjitura me ankesë janë dy dëshmi për çmimin e tregut për këtë pozicion. Një ofertë nga kompania Metal Ing e cila përfshin vetëm, furnizimin me llamarinë, ka çmim 23.2 euro dhe oferta e dytë nga kompania Solid me çmim 20.5 euro (çmime këto vetëm të furnizimit ku nuk përfshihen shpenzimet përcjellëse si montimi i pajisjeve). Dallimi në mes ofertës së NB Projekt dhe çmimeve të tregut është më shumë se 965%. Përderisa ne vazhdon pretendimin e tij OE ankues, jemi eliminuar për kinse çmime jonormalisht të ulëta në pesë pozicione, NB Projekt i ka nëntë pozicione ku ka dhënë çmime abuzive dhe jonormalisht të ulëta me dallime me çmime të tregut mbi 1000% (të gjitha rastet janë në ankesë). OE ankues kërkojnë që PSH të aplikoj standardin e njëjtë të rregullave Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët sipas praktikës së njëjtë të vendosur me vendimin me nr 755/19 të OSHP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se ankesa me nr. të protokollit 755/19, dt.28.10.2019, është parashtruar nga OE ankues "NB. Projekt" Shpk& NPN "Alping" & "Alping" Shpk-Deçan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku i rekomanduar për dhënie të kontratës ka qenë OE "Engineering Group" Sh.P.K, dhe të gjitha pretendimet e OE ankues "NB. Projekt" Shpk& NPN "Alping" & "Alping" Shpk-Deçan, kanë qenë për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës se i njëjti ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta. Paneli shqyrtues në vendimin PSH nr. 755/19, të dt. 03.12.2019, ka konstatuar që AK duhet të zbatoj nenin 61 të LPP-së dhe Rregullat B57 për çmimin jo normalisht të Ulëta për pozicionet e supozuara si

jo normalisht të ulëta nga ana e OE ankues “NB. Projekt” Shpk& NPN “Alping” & “Alping” Shpk-Deçan për operatorin ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës që ka qenë OE “Engineering Group” Sh.P.K.

Paneli shqyrtues sqaron se ankesa me nr. të protokollit 938/19, dt.19.12.2019, është parashtruar nga OE ankues “NB. Projekt” Shpk& NPN “Alping” & “Alping” Shpk-Deçan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku i rekomanduar për dhënie të kontratës ka qenë OE “Engineering Group” Sh.P.K, dhe se kjo ankesë ishte parashtruar nga ankuesi duke pretenduar se AK nuk kishte zbatuar vendimin e OSHP-së, PSH nr. 755/19, të dt. 03.12.2019. OSHP me dt. 27.01.2020, merr Urdhëresë me të cilën e urdhëron AK-në që të zbatohet vendimi i OSHP-së PSH nr. 755/19, të dt. 03.12.2019.

Paneli shqyrtues sqaron se në vendimet e lartcekura nuk janë kontestuar në asnjë pikë çmimet e pozicioneve të OE “NB. Projekt” Shpk& NPN “Alping” & “Alping” Shpk-Deçan, por këto pretendime janë ngritur vetëm me ankesën e OE Engineering Group” Sh.P.K., me nr. të protokollit 110/20, të dt. 18.02.2020, andaj duke u bazuar në faktet e prezantuara si më lart konstatojmë se me rastin e rivlerësimit autoriteti kontraktues është i obliguar që veproj në pajtim me nenin 61 të LPP-së dhe Rregullat B57 për çmime Jo normalisht të ulëta për OE “NB. Projekt” Shpk& NPN “Alping” & “Alping” Shpk-Deçan, në mënyrë që të respektohet neni 7 i LPP -së dhe të dy OE-të të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim, pra të vërtetohet se OE “NB. Projekt” Shpk& NPN “Alping” & “Alping” Shpk-Deçan a ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta për pozicionet e pretenduara nga ana e OE ankues “Engineering Group” Sh.P.K.

Lidhur me pretendimi e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ISO Certifikatë 9001 për ajrin e kondicionuar, ujësjellës dhe kanalizim, të cilat ishin kërkesa të domosdoshme të dosjes së tenderit. Në ofertën e dorëzuar nga operatori ekonomik është dorëzuar lista e certifikatave ISO duke përfshirë edhe Certifikatën ISO 9001. Sidoqoftë, në këtë certifikatë të dorëzuar mungojnë certifikimi për ajrin e kondicionuar, ujësjellës dhe kanalizim. Këto kërkesa janë cekur specifikisht në dosjen e tenderit si kushte themelore kumulative të cilat do të duhej të plotësoheshin.

Paneli shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit AK duhet të vërtetoj pretendimin e ngritur si më lart nga ana e OE ankues dhe të konstatoj se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës a ka plotësuar kërkesën e AK-së, të vendosur në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë për piken të cilën e konteston ankuesi.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se OE i rekomanduar për kontratë ka mungesa të dëshmimeve dhe dokumenteve në listën e pajisjeve të ofruara. Aty mungojnë dëshmitë dhe dokumentet për të paktën 4 pajisje esenciale. Dosja e tenderit ka kërkuar që të dorëzohen për çdo pajisje librezat e qarkullimit apo DUD-i doganor së bashku me foto të pajisjeve.

- Në marrëveshjen e OE të rekomanduar me kontratë Veding SHPK, në listën e pajisjeve mungojnë DUD-at doganore.
- Në marrëveshjen e OE të rekomanduar me Mirusha Company për pajisjen ngarkues i përdorur i prodhuesit O&K, modeli 25.5L, është ofruar kontrata e shitblerjes në mes të Mirusha Company dhe Lika Trade, mirëpo në DUD figuron një pronar tjetër, NTP Agnesa. Pra në DUD doganor kemi një pronar tjetër, ndërsa në marrëveshjen e NB Projekt ka lidhur marrëveshje me një kompani e cila nuk është pronare e kësaj pajisje. Në këtë rast AK nuk duhet të pranoj këtë pajisje, pasi që dy kompani nuk mund të merren vesh për të shfrytëzuar pajisjet e një kompanie të tretë e cila nuk është fare palë në këtë marrëveshje. Për këtë arsye OE NB Projekt duhet të shpallet i papërgjegjshëm.
- Për pajisjen bager të markës Liebherr A904C nuk ka ofruar DUD doganor.
- OE ka prezantuar faturë të shitblerjes për pajisjen Grejder Caterpillar 120G dhe cilindër Caterpillar CS-563E në emër të një kompanie tjetër. Marrëveshja e shitblerjes nuk është në emër të Mirusha Company, por Mirusha Transport. OE i rekomanduar për kontratë NB Projekt nuk ka marrëveshje të shfrytëzimit të pajisjeve me Mirusha Transport.
- OE i rekomanduar për kontratë, përveç se në shumë raste ka mungesa të dëshmimeve dhe dokumenteve për pajisjet e huazuara nga kompani të tjera, po ashtu vërehet qartë se asnjë pajisje nuk e ka në emër të saj. Të gjitha pajisjet e saja janë të huazuara nga operatorë të tjerë ekonomik, gjë e cila përshkruan më së miri kapacitetet e saja administrative dhe teknike për të realizuar një projekt të tillë siç është ndërtimi i Qendrës Rinore të Deçan.

Paneli shqyrtues për pretendimet e OE ankues te ngritura si më lart konstaton se me rastin e rivlerësimit autoriteti kontraktues është i obliguar që ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave ta bej në pajtim me nenin 59 të LPP-së, dhe të analizoj mire dëshmitë e kontestuar nga ankuesi për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, të vërtetohet se dëshmitë e kontestuar nga ankuesi a janë në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë

Paneli shqyrtues sqaron se gjate kohës se shqyrtimit te këtij aktiviteti ka pranuar nga OE i rekomanduar per kontrate nje email si me poshtë :

Te nderuar,

Ju informojm se keto dite, duke patur kohe edhe me shume per te qendruar pran kompjuterit, shikuum dosjen e kompanise ankuese me hollesisht edhe me antaret tjere te konzorciumit.

Ne pam ne dosjen e Operatorit Ankues se kishte disa verejtje dhe deklarime jo te verteta sa i perket stafit te prezentuar, andaj kerkojme nga OSHP qe te shikoj dhe vertetoj deklarimet e Operatorit Ankues.

Njeri nga stafi i prezentuar, kohe me pare kishte punuar se bashku ne disa projekte edhe me inxhinjer te kompanise sone, dhe inxhinjeret tane kan goxha informata per ate.

Behet fjale per inxhinjerin e hidroteknikes te prezentuar nga Operatori Ankues, Inxhinjerja **Mirvete Zuka Jaha**, Zonja ne fjale ka punuar ne KK Podujeve e tani eshte duke punuar ne MTI (Agjencia per Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) (Linku ku shihet qe Znj. Mirvete Jaha eshte e punesuar ne KIESA <https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1.4>), ketu ka edhe numrin kontaktues te saj. Ne nje dokument per staf te prezentuar nga OE "Informata Personale", shkruan qe znj. ne fjale ka qen e angazhuar ne KK Podujeve deri ne vitin 2014 e qe nga ajo kohe punon ne kete kompani. Kjo nuk eshte e vertete sepse znj. Mirvete Jaha ka punuar edhe pas vitit 2014 ne KK Podujeve, kete e deshmojne edhe referencat e leshuara nga KK Podujeve, ku edhe pse referencat jane te leshuara ne fund te vitit 2015, ne reference theksohet se znj. Mirvete Jaha vazhdon te punoj ne KK Podujeve, e besa ne e dijme edhe ne disa projekte qe ajo ka qen menaxhere e projektit. - Pra OE ka deklaruar te paverteta sepse nuk eshte e vertet qe znj ne fjale ka punuar vetem deri ne vitin 2014 ne KK Podujeve.

Gjithashtu duke e njohur znj ne fjale e duke e patur edhe menaxhere ne disa projekte (ne KK Podujeve) ne kemi dyshime te medha qe edhe nenshkrimi i cili eshte prezentuar ne kontrate e dokumente tjera, dyshojme qe eshte nenshkrimi i saj, ne e njohim nenshkrimin e saj.

Gjithashtu ne kontraten e prezentuar OE, ceket qe nese shperblehet me kontrate OE ne fjale, znj. Mirvete jaha do te punoje me orar te plote ne kete kompani, orari i punes eshte 40 ore ne jave. si dhe Neni 9 i kesaj kontrate qe nuk i takon pushimi vjetor etj etj. Ne konsiderojme qe per te gjitha keto znj. Mirvete Jaha as nuk eshte ne dijeni dhe as nuk e ka nenshkruar vete kete kontrate. Duke e njohur znj ne fjale, nuk ekziston as mundesia me e vogel qe ajo te len punen ne MTI e te filloje pune ne nje kompani ne Istog e te angazhohet ne nje projekt ne Deqan.

Pra, ne konsiderojme qe sa i perket inxhinjeres se Hidroteknikes, OE ka deklaruar goxha te paverteta.

E pasiqe per inxhinjerin e hidros ka goxha te paverteta ka mundesi qe edhe per inxhinjeret tjere te kete te paverteta.

Ne kerkojme nga OSHP te vertetoje shenimet e dokumentet e prezentuara nga OE, sidomos per znj. Mirvete Jaha.

Me respekt

NB PROJEKT sh.p.k.

Paneli Shqyrtues Obligon Autoritetin Kontraktues qe gjate rivlerësimit te vërtetoj se me te vërtete a është e falsifikuar kontrata e znj. Mirvete Jaha.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët si dhe neni 61 i LPP-së dhe Rregulla për tenderin jo normalisht të ulët B57.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - Kuvendi Komunal Deçan

1x1 OE –“Engineering Group”Sh.P.K

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.